



UNITED NATIONS
KOSOVO TEAM



2021

Vlerësimi i Shpejtë i Integruar: Përafrimi i politikave dhe disponueshmëria e të dhënave në Kosovë



SUSTAINABLE
DEVELOPMENT
GOALS

Lista e shkurtesave

Mirënjohje

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	1
Mirënjohje	1
Përmbledhje ekzekutive	2
1. Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm në nivel global dhe procesi i lokalizimit	4
2. Përafrimi i politikave në Kosovë me OZHQ-të	4
2.1 Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021	5
2.2 Politikat dhe strategjitë sektoriale	6
2.3 Përpjekjet aktuale për të përafruar politikat me SDG-të	8
3. Disponueshmëria e të dhënave	9
4. Rekomandimet	11
5. Annexes	12
Tabela 1: Caqet e ozhq-ve të përfshira në strategjitë dhe dokumentet e planifikimit të Kosovës	12
Tabela 2: Të dhëna që tashmë mblidhen përmes anketave	23
Tabela 3: Të dhëna nga burime administrative	27
Tabela 4: Të dhëna të disponueshme nga burime të tjera	29
Tabela 5: Të dhëna që mund të vihen në dispozicion lehtësisht	31
Tabela 6: Disa elementë të disponueshëm, por jo të gjithë	33
Tabela 7: Treguesit për të cilët të dhënat nuk janë të disponueshme	39

ATM	Makineri automatike të shitësit të ATM-ve
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
COVID-19	Sëmundja Coronavirus 2019
GANHRI	Aleanca Globale e Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut
HIV	Virusi i mungesës së imunitetit njerëzor
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IHR	Rregulloret Ndërkombëtare të Shëndetit
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
KB	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
KPQ	Konsumi dhe Prodhimi i Qëndrueshëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MICS	Anketa e Treguesve të Shumëfishtë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

HCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë të KB për të Drejtat e Njeriut
PM	Office of the UN High Commissioner for Human Rights
RIA	Office of the Prime Minister's Strategic Planning Office
SDG	Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm
SIDA	Sindromi i Mungesës së Imunitetit të Fituar
SMK	Strategjia mjedisore në Kosovë
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TRIPS	Aspekte të lidhura me tregtinë e të drejtave të pronësisë intelektuale
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
UNKT	Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZKD	Zyra e Koordinatorit të Zhvillimit të
ZKM / SPO	Zyra së Planifikimit Strategjik të Kryeministrit
WASH	Uji, higjiena dhe higjiena

Ky raport u porositi nga Zyra e Koordinatorit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (DCO) në Kosovë.¹ Hartuesi i tij është Matthew Naumann, konsulent i pavarur, në konsultim të ngushtë me përfaqësuesit e grupit për Monitorim, Vlerësim dhe Nxjerrje të Mësimeve. Raporti u bazua në ushtrimin e përafrimit të politikave dhe hartëzimit të të dhënave që veçse ishte iniciuar nga Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT). Gjetjet nga ushtrimi u përditësuan për të pasqyruar zhvillimet e fundit të politikave dhe analizën e disponueshmërisë së të dhënave.

Ky raport konsolidon rekomandimet e dhëna nga përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, të cilat u përmbledhën duke u bazuar në diskutimet e zhvilluara gjatë takimit të konsultimit online të mbajtur më 8 qershor 2021, nën udhëheqjen e Zyrës për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, me Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe UNKT-në.

¹ Adresimi për Kosovën bëhet në kuadër të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB (1999).

Përmbledhje ekzekutive

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm (Agjenda 2030) u miratua nga Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në vitin 2015. Agjenda 2030 shënoi një hap të rëndësishëm përpara në bashkëpunimin global dhe është bërë pika kryesore referuese për përpjekjet e Kosovës dhe ndërkombëtare që synojnë zgjidhjen e sfidave globale. Teksa Kuvendi i Kosovës e ka përkushtuar Kosovën ndaj Agjendës 2030, në Kosovë nuk ka ende sistem për matje të progresit drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) dhe caqeve dhe treguesve të tyre.

Në mënyrë që të mbështetet zhvillimi i një sistemi të tillë, Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë zhvilloi një Vlerësim të Shpejtë të Integruar të përafritimit të dokumenteve strategjike me OZHQ-të. Vlerësimi konstatoi se 36 objektiva ishin plotësisht të përafuara me OZHQ-të, ndërsa 84 objektiva ishin pjesërisht të përafuara dhe 8 objektiva nuk ishin të përafuara.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 u zhvillua para se të finalizoheshin OZHQ-të. Përkundër disa ndërlidhjeve, në SKZH 2016-2021 janë gjetur hendeke serioze në lidhje me kornizën e OZHQ-ve, përfshirë këtu mungesën e një vizioni për shëndetin dhe një fokus të ngushtë në sektorin e drejtësisë. Andaj, po bëhen më shumë

përpjekje për të siguruar që SKZH-ja e ardhshme ta pasqyrojë më mirë tërë Agjendën 2030.

Zyra për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit është duke zhvilluar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030 (SKZH 2030), për të mbuluar vitet 2021-2030. Qëllimi është që SKZH 2030 t'i integrojë në misionin e saj të përgjithshëm parimet kyçe të Agjendës 2030 dhe OZHQ-të, objektivat specifikë dhe treguesit e ndikimit. SKZH 2030 të zbatohet dhe monitorohet përmes një numri më të vogël të strategjive sektoriale dhe planeve të veprimit me kodet fikse buxhetore për të siguruar ndërlidhje më të mira me buxhetin e Kosovës.

Trajektorja e Kosovës drejt Agjendës 2030 lidhet drejtpërdrejt me përpjekjet e saj drejt përbushjes së kriterëve për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Për shembull, 63.9 për qind e treguesve në Raportin Kombëtar të Kosovës 2019 për BE-në janë tregues të përafuar me OZHQ-të.

Nevojiten të dhëna të besueshme, në kohë dhe të imtësishme për të treguar se po arrihet progres dhe fushat ku Kosova ka mbetur prapa. Pa të dhëna të mira për temat e treguesve, nuk ka asnjë mënyrë për të monitoruar trendet pozitive ose negative drejt arritjes së OZHQ-ve.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgjegjësinë e përgjithshme për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave për qëllime statistikore. Ky rol plotësohet nga ministritë e linjës. Është me rëndësi kritike që Kosovën ta zgjerojë më tej koordinimin në nivelin teknik dhe të përmirësojë qasjen në burimet e të dhënave të disponueshme administrative dhe përdorimin e tyre. Pengesat ndaj sigurimit të të dhënave të besueshme dhe me cilësi të lartë për përcjelljen e OZHQ-ve përfshijnë mungesën e përkufizimeve dhe metodologjive të standardizuara, si dhe mungesën e të dhënave të plota apo të zbërthyera.

Analiza ka konstatuar një panoramë të përzier për sa i përket disponueshmërisë së të dhënave për monitorimin e OZHQ-ve. Pothuajse nuk ka të dhëna për OZHQ-të **10, 11, 12, 13** dhe **14**, dhe ka hendeke të konsiderueshme të disponueshmërisë së të dhënave për OZHQ-të **2, 6, 9** dhe **15**. Për pjesën tjetër (që kanë disponueshmëri të ndryshme të të dhënave), sfidat përfshijnë mbledhjen në mënyrë rutinore vetëm të të dhënave të kufizuara, mungesën e të dhënave në seri kohore për të monitoruar progresin, dhe faktin se të dhënat nuk zbërthehen për të identifikuar hendeket e ekuitetit.

Nga treguesit e konsideruar relevantë për Kosovën, anketa të ndryshme, veçanërisht Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë, tashmë mbledhin të dhëna për 35 tregues të progresit. Informata për 8 tregues të tjerë të progresit mund të gjenden në të dhënat administrative, kryesisht nga Institucionet e Kosovës, si dhe nga Instituti GAP, një institut hulumtuës në Kosovë. Sidoqoftë, të dhënat për disa prej tyre vijnë nga 10 vjet më parë. Të dhënat për 15 tregues të tjerë janë të disponueshme nga të dhënat e Bankës Botërore dhe burime të tjera.

Për 16 tregues për të cilët aktualisht nuk ka të dhëna të disponueshme, do të ishte e thjeshtë që Institucionet e Kosovës të ndërmarrin hapa të menjëhershëm për t'i llogaritur dhe publikuar bazuar në informatat e zotëruara tashmë nga institucionet. Për shembull, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP) mbledh të dhëna për infeksionet me HIV (Treguesi 3.3.1) por këto nuk janë aktualisht të disponueshme për publikun. Ka të dhëna të disponueshme për numrin e vetëvrasjeve të kryera, dhe këto mund të kombinohet me të dhënat demografike dhe të publikohen për shkallën e vdekshmërisë nga vetëvrasjet (Treguesi 3.4.2).

Për një grup prej 37 treguesish të dhënat janë pjesërisht të

disponueshme, ose nuk është e qartë nëse të dhënat janë të disponueshme apo jo, ose të dhënat janë të vjetruara: këta tregues duhet të shqyrtohen nga Institucionet e Kosovës, për të përcaktuar nëse dhe si duhet të pasqyrohen në mekanizmin për raportim të Kosovës. Për grupin përfundimtar të 53 treguesve, nuk ka të dhëna të disponueshme, dhe ato duhet të shqyrtohen për të përcaktuar nëse do të raportohen për Kosovën.

Rekomandimet e mëposhtme janë zhvilluar si rezultat i një procesi të përbashkët dhe konsultativ me përfaqësuesit e Institucioneve të Kosovës, në mënyrë që të shfrytëzohen gjetjet e këtij raporti të Vlerësimit të Shpejtë të Integruar. Më 8 qershor 2021 u mbajt një punëtori gjysmë ditore për të diskutuar dhe hartuar rekomandime specifike dhe të matshme që do të çohen më tej nga institucionet relevante për zbatim të mëtejshëm.

Në përputhje me përpjekjet e Kosovës për ta integruar agjendën e OZHQ-ve në nivelin qendror dhe lokal, dhe pas diskutimeve me institucionet relevante dhe palët e interesit, rekomandimet janë grupuar në tri kategori kryesore, duke pasqyruar drejtimet e punës me rëndësi kritike, të cilat kërkohen për ta avancuar punën e OZHQ-ve:

Avokimi dhe koordinimi për zbatimin e Agjendës 2030

- Institucionet e Kosovës duhet të krijojnë mekanizma koordinues, duke përfshirë pikat e fokusit për secilin institucion, për zbatimin e OZHQ-ve

dhe monitorimin e progresit, duke siguruar integrimin e OZHQ-ve në dokumentet strategjike dhe të politikave dhe përdorimin e të dhënave të disponueshme.

- Kuvendi duhet të shfrytëzojë rolin e tij legjislativ dhe të vazhdojë avokimin për OZHQ-të dhe zhvillimin e qëndrueshëm duke forcuar partneritetet me individë, institute studimore dhe organizata të shoqërisë civile, sektorin publik dhe privat, botën akademike dhe mediat, për të monitoruar zbatimin e Agjendës 2030.
- Kuvendi duhet t'i vlerësojë dhe përmirësojë kapacitetet aktuale të deputetëve të Kuvendit për t'u angazhuar dhe për të avokuar drejt arritjes së OZHQ-ve.

Përafrimi dhe integrimi i OZHQ-ve në kuadër të strategjive dhe dokumenteve të politikave

- Institucionet e Kosovës duhet të sigurojnë integrimin dhe përafrimin e Strategjisë së ardhshme Kombëtare për Zhvillim, strategjive sektoriale dhe dokumenteve të tjera të politikave me synimet, treguesit dhe caqet e OZHQ-ve, duke siguruar etiketim adekuat për monitorim dhe raportim më të lehtë të progresit.
- Institucionet e Kosovës duhet të sigurojnë etiketim sistematik dhe adekuat për caqet dhe treguesit e OZHQ-ve në dokumentet e politikave dhe strategjive për të mundësuar monitorimin e progresit dhe për të kontribuar për Agjendën 2030 dhe OZHQ-të.

Rritja e disponueshmërisë së të dhënave në përputhje me metodologjinë ndërkombëtare për përcjelljen e progresit drejt Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve

- ASK-ja duhet t'i shqyrtojë treguesit që janë pjesërisht të disponueshëm apo ende jo të disponueshëm, për të përcaktuar pikat e hyrjes për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin në kohën e duhur për këta tregues, për ta përshpejtuar progresin drejt Agjendës 2030.
- ASK-ja dhe Institucionet e Kosovës duhet t'i përshtatin caqet dhe treguesit e OZHQ-ve me rrethanat lokale dhe t'i harmonizojnë me kërkesat e anëtarësimit në BE dhe prioritetet përmes një procesi të mbështetur në pronësi të fortë dhe që promovon pjesëmarrjen e të gjitha palëve relevante të interesit.
- ASK-ja duhet të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të siguruar disponueshmërinë e të dhënave që ende nuk janë të disponueshme, të cilat mund të llogariten dhe publikohen bazuar në informatat e zotëruara tashmë nga institucionet.
- ASK-ja duhet t'i konsolidojë në mënyrë sistematike treguesit e OZHQ-ve për të cilët tashmë mbledhen të dhëna në anketa dhe të dhëna administrative, si dhe të raportojë për progresin drejt tyre duke iu referuar treguesve specifikë të OZHQ-ve për referencë dhe përdorim të lehtë.
- ASK-ja duhet të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për gjenerimin e dëshmive.

- ASK-ja duhet të forcojë partneritetin me institucionet e nivelit lokal për gjenerimin dhe shkëmbimin e të dhënave në nivelin lokal.
- ASK-ja duhet të zhvillojë një metodologji e fuqishme për përcjelljen e progresit në zbatim dhe rezultateve kundrejt caqeve të BE-së dhe caqeve globale të OZHQ-ve, për të ndërtuar kapacitetin statistikor për mbështetjen e TI-së dhe mbledhjen e të dhënave, dhe, në fund të fundit, për ta realizuar Agjendën 2030.
- ASK-ja duhet të krijojë një bazë të të dhënave për OZHQ-të që është e lehtë për përdoruesit e ueb faqes së ASK-së, në mënyrë që të rritet përdorimi i të dhënave.



1. Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm në nivel global dhe procesi i lokalizimit

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm (Agjenda 2030) u miratua nga Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në vitin 2015. Agjenda 2030 shënoi një hap të rëndësishëm përpara në bashkëpunimin global dhe është bërë pika kryesore referuese për përpjekjet kombëtare dhe ndërkombëtare që synojnë zgjidhjen e sfidave globale.² Agjenda 2030 udhëhiqet nga 17 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ), të cilat përbëjnë kornizën e vizionit të zhvillimit të qëndrueshëm përmes një kombinimi të objektivave sociale, ekonomike dhe mjedisore, të formësuara nga “5 P-të”:

Njerëzit (OZHQ-të **1, 2, 3, 4** dhe **5**), Planeti (OZHQ-të **6, 13, 14, 15**), Prosperiteti (OZHQ-të **7, 8, 9, 10, 11, 12**), Paqja (OZHQ **16**) dhe Partneritetet (OZHQ **17**). Teksa këto 17 OZHQ përcaktojnë synimet e përgjithshme, u vendosën edhe 169 caqe specifike për të drejtuar zbatimin e agjendës drejt synimeve përfundimtare për dhënien fund të të gjitha formave të varfërisë, adresimin e sfidave mjedisore dhe moslënien e askujt pas.³

² Platforma e Njohurive për Zhvillim të Qëndrueshëm, “Transformimi i botës sonë: Agjenda 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm”, OKB, në <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transforming-ourworld>

³ Zyra e Planifikimit Strategjik, Raporti i parë mbi zbatimin dhe rezultatet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016–2021, tetor 2018, në <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/02/First-Report-on-the-implementation-and-results-of-the-National-Development-Strategy-2016%E2%80%932021.pdf>

Shumë vende po e përkthejnë këtë vizion dhe plan të përbashkët për prosperitetin e njerëzve dhe planetit në plane dhe strategji zhvillimore kombëtare, me synimin për të lehtësuar nacionalizimin, zbatimin dhe arritjen e plotë të OZHQ-ve. Procesi i nacionalizimit të OZHQ-ve përfshin integrimin e caqeve të OZHQ-ve në kornizën strategjike kombëtare, buxhetimin e qëndrueshëm, si dhe krijimin e sistemeve të raportimit dhe vlerësimit për të monitoruar progresin drejt caqeve të dakorduara globalisht.⁴ Vendet fqinje me Kosovën tashmë kanë krijuar strategji për “nacionalizimin” e Agjendës 2030 dhe kanë publikuar raporte të progresit mbi zbatimin e OZHQ-ve. Ata gjithashtu kanë mekanizma të qartë financimi për t’i përmbushur ato.⁵

⁴ Zyra e Planifikimit Strategjik, Raporti i parë mbi zbatimin dhe rezultatet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016–2021, tetor 2018, në <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/02/First-Report-on-the-implementation-and-results-of-the-National-Development-Strategy-2016%E2%80%932021.pdf>

⁵ Hermonda Kalludra dhe Burim Ejupi, Kosova dhe Agjenda 2030: nga retorika politike në veprime konkrete, INDEP, korrik 2019, në https://indep.info/wp-content/uploads/2019/07/SDG_ENG.pdf

2. Përafrimi i politikave në Kosovës me OZHQ-të

Tre vjet pas miratimit global të Agjendës 2030, Kuvendi i Kosovës ka hedhur hapa shtesë për t’iu bashkuar përpjekjeve globale për një botë më të mirë deri në vitin 2030.⁶ Një Rezolutë e vitit 2018 i mbështet vullnetarisht OZHQ-të dhe e angazhon Kosovën në synimet globale. Në tetor 2018, Kuvendi themeloi Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm, një grup parlamentar, për të udhëhequr dhe koordinuar përpjekjet në të gjithë komisionet ekzistuese të Kuvendit drejt arritjes së OZHQ-ve.

Momentalisht, Shqipëria dhe Mali i Zi kanë vendosur sisteme më gjithëpërfshirëse në mbështetje të zbatimit dhe monitorimit të OZHQ-ve. Siç theksohet në raportin “Maksimizimi i sinergjive ndërmjet Agjendës 2030 dhe integritit të Kosovës në BE”, edhe “kanalet institucionale në mbështetje të zbatimit të OZHQ-ve ndryshojnë bazuar në strukturën e proceseve strategjike dhe të planifikimit të politikave, buxhetimin specifik dhe linjat e raportimit për të ndjekur progresin, dhe kapacitetin e kornizave përkatëse ligjore dhe administrative. Të gjithë

⁶ Kosova ka një histori më të gjatë të mbështetjes së agjendës globale të zhvillimit të qëndrueshëm. Kjo përfshin mbështetjen nga Kuvendi i Kosovës për Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) në vitin 2008, pjesëmarrjen e rreth 9,000 kosovarëve në konsultimet për periudhën pas vitit 2015 të sponsorizuara nga OKB-ja gjatë vitit 2013, dhe “lansimin” nga UNKT të OZHQ-ve në Kosovë në Ditën e OKB-së (24 tetor) në 2015

kandidatët e BE-së dhe kandidatët e mundshëm kanë caktuar ose krijuar një organ përgjegjës për mbikëqyrjen e progresit në lidhje me zbatimin dhe monitorimin e OZHQ-ve. Në përgjithësi, organet e përcaktuara tashmë mbajnë role koordinimi, drejtohen nga një zyrtar qeveritar i nivelit të lartë ose departamenti/njësia e caktuar e ministrisë dhe angazhojnë përfaqësues të ministrive relevante dhe agjencive qeveritare.”

Sidoqoftë, përkundër angazhimit ndaj agjendës së OZHQ-ve, aktualisht në Kosovë nuk ka sistem për të matur progresin drejt treguesve. Kosova megjithatë ka ndërmarrë një ushtrim për përafrim të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (2016-2021) me OZHQ-të për të cilat është bërë një raport i progresit në vitin 2018, dhe po vazhdon përpjekjet për t’i integruar OZHQ-të në dokumentet e politikave, përderisa matja e progresit drejt OZHQ-ve po sistematizohet.

Për të ndihmuar në adresimin e këtij deficieti, nën udhëheqjen e nga UNKT-së, agjencitë e OKB-së iniciuan një vlerësim të shpejtë të integruar (VshI), Rappid Integrated Assessment ne gjuhën angleze, i cili vlerësoi përafrimin e OZHQ-ve me 58 dokumente strategjike të Kosovës, disa prej të cilave së bashku me planet e veprimit,

dhe hartëzimin e të dhënave. Metodologjia e VShI-së përdoret nga Kombet e Bashkuara globalisht për të siguruar një pamje të shpejtë të nivelit të përafrimit mes planeve dhe strategjive (në nivele kombëtare ose nën-kombëtare), planeve sektoriale dhe caqeve të OZHQ-ve. Nga secili prej dokumenteve të planifikimit në dispozicion, identifikohet synimi/caku më i afërt që adreson çështjet në synimin/cakun përkatës të OZHQ-ve. Kur krahason synimin/cakun kombëtar (nëse ekziston në dokumentin e planifikimit) me cakun përkatës të OZHQ-ve, metodologjia tregon nëse synimi/caku i OZHQ-ve pasqyrohet në dokumentin e planifikimit dhe, nëse po, tregon nëse caku është plotësisht ose pjesërisht i përafruar me synime/caqe vendore. Ekzistojnë tre nivele të mundshme të përafrimit:

- *I përafruar plotësisht:* Ka një cak në dokumentin kombëtar të planifikimit që korrespondon me një cak të

OZHQ-ve, jo vetëm në tekst, por edhe në fushëveprim dhe ambicie. Në disa raste, janë përcaktuar tregues për të matur progresin e tyre dhe/ose burimet e alokuara.

- *I përafruar pjesërisht:* Ka një cak në dokumentin kombëtar të planifikimit që korrespondon me një cak të OZHQ-ve, por jo plotësisht në fushëveprim ose ambicie, ose nuk ka tregues për të matur progresin e tyre.
- *Nuk është i përafruar:* Nuk ka një cak ekuivalent në dokumentin kombëtar të planifikimit me atë të OZHQ-së në fjalë.

Analiza e shprehur në përqindje në tabelën më poshtë zbuloi se 36 objektiva të 10 dokumenteve ishin plotësisht të përafruar me OZHQ-të, ndërsa 84 objektiva të 28 dokumenteve ishin pjesërisht të përafruar, dhe 8 objektiva të 5 dokumenteve nuk janë të përafruar.

2.1 Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021

Në vitin 2016, institucionet e Kosovës nxorën një dokument kyç të politikave, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021 për të përcaktuar rrugën e zhvillimit të vendit për pesë vitet e ardhshme. SKZH 2016-2021, e cila ishte strategjia e parë e këtij lloji për Kosovën, u dakordua para se të finalizoheshin OZHQ-të, dhe Strategjia fillimisht nuk ishte dizajnuar që të përafrohej me Agjendën 2030.

Në vitin 2017, Zyra e Planifikimit Strategjik/Zyra e Kryeministrit, me mbështetjen e Ekspertëve të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT), zhvilloi një ushtrim për përafrimin e SKZH-së me synimet dhe caqet e OZHQ. Ushtrimi i përafrimit theksoi se SKZH-ja përfshin elementë që do të kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e caqeve të OZHQ-ve gjatë zbatimit të SKZH-së. Teksa SKZH-ja nuk i mbulon të gjitha aspektet e OZHQ-ve, mbulimi relativisht i mirë i OZHQ-ve dhe caqeve të tyre krijon një precedent premtues për kornizën e planifikimit strategjik të ardhshëm nga optika e OZHQ-ve në vitet e ardhshme. SKZH-ja u gjet të ishte në përputhje me 12 OZHQ dhe 22 caqe të OZHQ-ve, nga gjithsej 17 OZHQ dhe 169 caqe të OZHQ-ve. Njëzet e shtatë tregues të SKZH-së ishin në përputhje me 12 të OZHQ-ve.⁷

Dokumenti i Zyrës së Planifikimit Strategjik bazohet në udhërrëfyesin e

SKZH-së dhe metodologjinë për raportimin dhe monitorimin e zbatimit, rezultateve dhe financimit të SKZH-së. Ai raporton mbi gjendjen e zbatimit në fund të vitit 2017 dhe përdor vlerat e rezultateve të treguesve në dispozicion deri në qershor 2018. Raporti thekson (fq. 39) se, në SKZH “mbulimi relativisht i mirë i OZHQ-ve dhe caqeve të tyre krijon një precedent premtues për kornizën e planifikimit strategjik të ardhshëm nga optika e OZHQ-ve në vitet e ardhshme”. Gjithashtu, aty thuhet se: “Në dy vitet e para të zbatimit të SKZH-së, janë raportuar të dhëna për të matur progresin për të gjitha OZHQ-të e përafruara (qoftë plotësisht ose pjesërisht), me përjashtim të të dhënave për të matur progresin drejt OZHQ-2...” Përafrimi i SKZH-së me OZHQ-të ka krijuar bazën për procesin e nacionalizimit të OZHQ-ve dhe do të mundësojë monitorimin dhe raportimin efektiv të progresit të bërë drejt një numri të caqeve të OZHQ-ve. Kjo paraqet integrimin aktual të OZHQ-ve në agjendën e Kosovës dhe sinjalizon përkushtimin e Kosovës për arritjen e OZHQ-ve.

Sidoqoftë, në dokumentet e planifikimit të Kosovës janë gjetur hendeqe serioze në lidhje me kornizën e OZHQ-ve. Për shembull, SKZH-ja 2016-2021 nuk ka vizion për shëndetin dhe fokus të ngushtë në sektorin e drejtësisë. Prandaj po bëhen më shumë përpjekje për të siguruar që SKZH-ja e ardhshme ta pasqyrojë më mirë tërë Agjendën 2030.

⁷ Zyra e Planifikimit Strategjik, Raporti i parë mbi zbatimin dhe rezultatet e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016–2021, tetor 2018, në <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2019/02/First-Report-on-the-implementation-and-results-of-the-National-Development-Strategy-2016%E2%80%932021.pdf>.

⁸ Po aty, fq. 39

Përafrimi i përgjithshëm i politikave me OZHQ-të

- Pjesërisht
- Plotësisht
- Nuk është i përafruar




Figura 1: Përafrimi i përgjithshëm i politikave me OZHQ-të

2.2 Politikat dhe strategjitë sektoriale

Përveç Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, Kosova ka një numër shumë të lartë të politikave dhe strategjive sektoriale që gjithashtu përmbajnë tregues, shumë prej të cilëve janë tregues të OZHQ-ve.⁹ Disa nga këto janë zhvilluar para Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, ndërsa të tjerët kanë për qëllim ta plotësojnë atë. SKZH-ja deklaroi se gjatë alokimit të burimeve prioritet duhet t'u jepet detyrë të përcaktuara në SKZH.¹⁰ Sidoqoftë, strategjitë sektoriale ofrojnë një pamje më gjithëpërfshirëse të asaj që Kosova synon të arrijë, dhe shkallën në të cilën këto caqe përputhen me ato të OZHQ-ve.

Vlerësimi i Shpejtë i Integruar i kryer në vitin 2020 (shih më lart) i shqyrtoi strategjitë dhe programet ekzistuese¹¹ dhe zbuloi se 59 për qind e caqeve të OZHQ-ve ishin pasqyruar në të paktën një nga dokumentet strategjike të Kosovës. Siç mund të shihet në Tabelën 1 më poshtë, të gjithë caqet për ndryshimet klimatike (OZHQ 13)

⁹ Kosova e pranon që numri i strategjive sektoriale e bën më të vështirë raportimin, koordinimin dhe, në fund të fundit, arrijtjen e caqeve. Një shqyrtim i vitit 2020 sugjeroi që strategjitë dhe programet sektoriale të konsolidohen në 18-20 dokumente strategjike sektoriale [Propozimi për udhërrëfyesin për një SKZH të re të Kosovës, maj 2020]

¹⁰ Zyra e Planifikimit Strategjik, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016–2021, 2016, http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf

¹¹ Disa nga këto do të skadonin në vitin 2020, ndërsa të tjerat - të tilla si Strategjia e Barazisë Gjinore dhe Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve - u nxorën pas kryerjes së analizës.

gjenden në programet strategjike të Kosovës, së bashku me 90 për qind të atyre për OZHQ 4 (arsimi) dhe 89 për qind për OZHQ 5 (gjinia). Asnjë cak nuk ishte i përafëruar për OZHQ 2 (uria) ose OZHQ 14 (oqeanet): kjo e fundit pritej, pasi Kosova nuk ka dalje në det.

Në të gjithë dokumentet e planifikimit, mund të shihet se disa përmbajnë shumë tregues të përafëruar me OZHQ-të (Tabela 3). Për shembull, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021 përmbante 17 tregues të përafëruar me OZHQ-të, të gjithë përveç njërit në kuadër të OZHQ 4 (Arsimi) - tjetri është për OZHQ 9 (Industria, inovacioni dhe infrastruktura). Ndërkohë, Strategjia Mjedisore e Kosovës (SMK) 2013-2022 përmbante 8 tregues të përafëruar me OZHQ-të, nën gjashtë OZHQ të ndryshme (6, 8, 9, 11, 12 dhe 13). Strategjia Sektoriale e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ka 7 tregues të përafëruar me OZHQ-të, nga OZHQ-të 1 (varfëria) dhe 8 (punësimi), ndërsa Strategjia Sektoriale për Shëndetësinë ka 13, të gjithë për OZHQ 3 (shëndetësia). E fundit, me më shumë se pesë tregues të përafëruar me OZHQ-të, është SPKRASHK, e cila ka 8, nën OZHQ 1 (varfëria), 3 (shëndetësia) dhe 4 (arsimi).

Përafrimi me OZHQ-të në dokumentet e planifikimit të politikave të Kosovës




Figura 2: Përafrimi me OZHQ-të në dokumentet e planifikimit të politikave të Kosovës

2.2 Politikat dhe strategjitë sektoriale

POLITIKAT RREGULLATIVE DHE DOKUMENTET E VLERËSUARA	% e përafrimit	% i caqeve të përputhur	% i caqeve globale te OZHQ-ve
1. VARFËRIA	57	4	7
2. URIA	38	3	8
3. SHËNDETI	85	11	13
4. ARSIMIMI	100	10	10
5. GJINIA	89	8	9
6. UJI	38	3	8
7. ENERGJIA	60	3	5
8. RRIJTJA DHE PUNËSIMI	67	8	12
9. INFRASTRUKTURA DHE INDUSTRIALIZIMI	88	7	8
10. PADREJTËSITË	50	5	10
11. QYTETET	80	8	10
12. KQP	36	4	11
13. NDRYSHIMI KLIMATIK	40	2	5
14. OQEANET	0	0	10
15. TOKAT	50	6	12
16. QEVERISJA GJITHËPËRFSHIRËSE	100	12	12
17. PARTNERITET	32	6	19
	59	100	169

2.3 Përpjekjet aktuale për të përafruar politikat me OZHQ-të

SKZH-ja aktuale është në vitin e fundit të zbatimit. Në këtë kontekst, Institucionet e Kosovës po përpunojnë përpjekjet drejt Agjendës 2030. Zyra e Planifikimit Strategjik në Zyrën e Kryeministrit është duke zhvilluar "Strategjinë Kombëtare për Zhvillim" 2030 (SKZH 2030), për të mbuluar vitet 2021-2030. Qëllimi është që SKZH-ja 2030 të integrojë parimet kyçe të Agjendës 2030 dhe OZHQ-të në misionin e saj të përgjithshëm, objektivat specifikë dhe treguesit e ndikimit. Pritet që SKZH-ja 2030 të zbatohet dhe monitorohet përmes strategjive sektoriale dhe planeve të veprimit me kodet fikse buxhetore për të siguruar lidhje më të mira me buxhetin e Kosovës. Siç tregohet më lart, ZKM/ZPS -ja gjithashtu është zotuar që për periudhën e SKZH-së 2030 të zvogëlohet numri i strategjive dhe të vendosen kritere të qarta se kush mund të propozojë strategji të reja.¹²

Trajektorja e Kosovës drejt Agjendës 2030 lidhet drejtpërdrejt me përpjekjet e saj drejt përmbushjes së kriterëve për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Për shembull, 63.9 për qind e treguesve në Raportin Kombëtar të Kosovës 2019 për BE-në janë tregues të përafruar me OZHQ-të.

¹² Zyra e Kryeministrit, *Strategjia e Rregullimit më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021*

Sidoqoftë, duhet të theksohet se Eurostat ka filluar të raportojë për progresin e OZHQ-ve në Kosovë duke përdorur tregues të përafruar me OZHQ-të që ishin krijuar për t'u përdorur në vendet anëtare të BE-së me nivele shumë më të larta të të hyrave dhe struktura të ndryshme socio-ekonomike. Teksa treguesit e BE-së janë kritikë, nuk janë përfshirë disa nga çështjet që janë thelbësore për vendet me të hyra të ulëta dhe të mesme.

Në këtë kontekst, Kosovës ende i duhet një metodologji e fuqishme për ndjekjen e progresit në zbatim dhe rezultateve kundrejt civeve të BE-së dhe OZHQ-ve, për të ndërtuar kapacitetin statistikor për mbështetjen e TI-së dhe mbledhjen e të dhënave, dhe, në fund të fundit, për ta realizuar Agjendën 2030.

Përpjekjet drejt arritjes së OZHQ-ve do të ndikohen edhe nga pandemia COVID-19. Siç është thënë nga Kombet e Bashkuara: "Teksa kriza po vë në rrezik progresin drejt OZHQ-ve, ajo gjithashtu i bën arritjet e tyre gjithnjë e më urgjente dhe të domosdoshme. Është thelbësore që arritjet e fundit të mbrohen sa më shumë që të jetë e mundur. Duhet të synohet një rimëkëmbje transformuese nga COVID-19, e tillë që e adreson krizën, i zvogëlon risqet nga krizat e mundshme

të ardhshme, dhe rifillon përpjekjet e zbatimit për realizimin e Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve gjatë Dekadës së Veprimit."¹³ Përpjekjet e Kosovës për rimëkëmbjen e saj nga COVID-19, mund të plotësohen dhe të forcohen nga përpjekjet për ta arritur Agjendën 2030 dhe për t'i përmbushur OZHQ-të. Kjo u pranua në Planin për Reagim Social-Ekonomik ndaj COVID-19, i hartuar nga Ekipi i Kombeve të Bashkuara dhe i botuar në gusht 2020, i cili theksoi se aplikimi i një qasjeje të OZHQ-ve dhe financave zhvillimore për reagimin ndaj COVID-19, do të ishte i dobishëm dhe do të lidhej mirë me Forumin e Donatorëve të Kosovës.¹⁴

¹³ Kombet e Bashkuara, *Dekada e Veprimit*, <https://www.un.org/sustainabledevelopment/decade-of-action/>, qasur më 18 shkurt 2021.

¹⁴ United Nations, *United Nations Kosovo Team Socio-Economic Response Plan to COVID-19, August 2020*, at https://kosovo-team.un.org/sites/default/files/2020-11/UNKT-Socio-Economic-Response-Plan-to-COVID_19_24%20August%202020.pdf



3. Disponueshmëria e të dhënave

Nuk është e mundur të matet progresi i bërë drejt Agjendës 2030 pa mjetet e duhura për ta matur atë. Nevojiten të dhëna të besueshme, në kohë dhe të imtësishme për të treguar se ku po bëjmë përparim dhe ku jemi prapa. Pa të dhëna të mira për temat e treguesve, nuk ka asnjë mënyrë për të monitoruar trendet pozitive ose negative drejt arritjes së OZHQ-ve.¹⁵

Sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgjegjësinë e përgjithshme për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave për qëllime statistikore. Ky rol plotësohet nga ministritë e linjës.¹⁶


Sipas Raportit të Progresit të Bashkimit Evropian, Kosova ka një nivel të pjeserishëm të përgatitjes në fushën e statistikave. Vihet re se është bërë progres në përmirësimin e metodologjisë për mbledhjen e të dhënave dhe me ratifikimin dhe ndryshimin e ligjit për statistikën. Sidoqoftë është me rëndësi për Kosovën që të përmirësojë më tej koordinimin në nivelin teknik dhe të përmirësojë qasjen dhe përdorimin e

burimeve të disponueshme të të dhënave administrative.¹⁷ Disa nga sfidat kryesore të të dhënave janë të lidhura me cilësinë e të dhënave për shkak të mungesës së standardizimit të përkufizimeve dhe metodologjive dhe disponueshmërisë së kufizuar të të dhënave. Duke pasur parasysh rëndësinë e të dhënave për zhvillimin e Kosovës, është thelbësore që këto çështje të adresohen në mënyrë të shpejtë.¹⁸

Pengesat ndaj sigurimit të të dhënave të besueshme dhe me cilësi të lartë për ndjekjen e OZHQ-ve, përfshijnë mungesën e përkufizimeve dhe metodologjive të standardizuara, të dhëna të kufizuara të zbërthyer ose të dhëna jo të plota, koordinimin e dobët, mungesën e depove qendrore për monitorim, dhe burimet e pamjaftueshme njerëzore dhe financiare për gjenerimin e dëshmimeve. Kjo është e vërtetë për çdo OZHQ - në shkallë të ndryshme - si në nivel global ashtu edhe në Kosovë, dhe parandalon të kuptuarit e përparimeve specifike që po bëhen. Ky informacion duhet të mblidhet në bazë të treguesve të përbashkët dhe globalë që lehtësojnë matjen e ndikimit dhe respektojnë privatësinë e individëve.

Hartëzimi gjithëpërfshirës i të dhënave të OZHQ-ve i ndërmarrë në Kosovë tregon se ndryshon shumë shkalla në të cilën maten, ose në fakt janë lehtësisht të matshëm, treguesit e përafuar me OZHQ-të. Ende nuk ka ndonjë mënyrë të dakorduar ndërkombëtarisht për të matur rreth 36 nga treguesit e OZHQ-ve, të cilët klasifikohen si tregues të nivelit III. 14 tregues të tjerë duket se nuk janë relevantë për Kosovën, siç janë treguesit që lidhen me sëmundjet tropikale, gjymtimin e organeve gjenitale të grave, dhe resurset detare.

Disponueshmëria e treguesve të OZHQ-ve



Për OZHQ-të specifike, pothuajse nuk ka të dhëna për OZHQ-të 10, 11, 12, 13 dhe 14, dhe ka hendekë të konsiderueshme të disponueshmërisë së të dhënave për OZHQ-të 2, 6, 9 dhe 15. Për pjesën tjetër që kanë disponueshmëri të ndryshme të të dhënave, ka sfida të tilla si mbledhja e të dhënave të kufizuara në mënyrë rutinore, mungesa e të dhënave në seri kohore për të monitoruar progresin, dhe të dhënat nuk zërthehen për të identifikuar hendekët e ekuitetit.

Nga treguesit që konsiderohen relevantë për Kosovën, 35 mblidhen tashmë nga anketa. Nga këto të dhëna të anketave, 8 tregues të OZHQ-ve u raportuan për herë të parë në raportin e Anketës Klaster me Tregues të Shumëfishtë (AKTSH) të vitit 2020, ndërsa 19 të tjerë ishin mbledhur tashmë në anketën AKTSH për vitet 2013-14. Treguesit e gjetur në burimet e anketës paraqiten në Aneksin 1.

Ndërkohë, 8 tregues të tjerë mund të gjenden në të dhënat administrative, kryesisht nga Institucionet e Kosovës, si dhe nga Instituti GAP, një institut hulumtues në Kosovë (Aneksi 2). Me përjashtim të dy treguesve nga Statistikat Shëndetësore, të gjithë janë nga burime të ndryshme. Të dhënat për vendbanimet informale (treguesi 11.1.1) dhe zonat e pyllëzuara (15.1.1) janë veçanërisht të vjetra, përkatësisht nga viti 2010 dhe 2012. 15 tregues të tjerë (Aneksi 3) janë në dispozicion nga të dhënat e Bankës Botërore dhe burime të tjera. Për 16 tregues që nuk janë aktualisht në

¹⁵ Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Çështjet Ekonomike dhe Sociale, Për të arritur SDG-të ne duhet t'u besojmë të dhënave tona, 2017, UNICEF, Analiza e Situatës së Grave dhe Fëmijëve në Kosovë, 2019, në <https://www.un.org/development/desa/en/news/nocat-uncategorized/big-data-for-sdgs.html>


¹⁶ Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Çështjet Ekonomike dhe Sociale, Për të arritur SDG-të ne duhet t'u besojmë të dhënave tona, 2017, UNICEF, Analiza e Situatës së Grave dhe Fëmijëve në Kosovë, 2019, në <https://www.un.org/development/desa/en/news/nocat-uncategorized/big-data-for-sdgs.html>

¹⁷ Bashkimi Evropian, Raporti Kosovë 2020, 2020, në https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/default/files/kosovo_report_2020.pdf, f. 103

¹⁸ UNICEF, Analiza e Situatës së Grave dhe Fëmijëve në Kosovë, 2019, në <https://www.unicef.org/kosovoprogramme/media/1141/-file/SITAN.pdf>, fq. 85

dispozicion, do të ishte e thjeshtë që Institucionet e Kosovës të ndërmarrin hapa të menjëhershëm për të siguruar disponueshmërinë e të dhënave (Aneksi 4). Këta tregues mund të llogariten dhe publikohen bazuar në informacionin e zotëruar tashmë nga institucionet. Për shembull, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP) mbledh të dhëna për infeksionet HIV (treguesi 3.3.1), por këto nuk janë aktualisht në dispozicion të publikut; ndërsa janë të disponueshme të dhënat për numrin e vetëvrasjeve, dhe kjo mund të kombinohet me të dhëna demografike dhe të publikohet për shkallën e vdekshmërisë nga vetëvrasjet (treguesi 3.4.2).

Një grup prej 37 treguesish janë pjesërisht të disponueshëm, (Aneksi 6, i cili përmban shënime mbi statusin e treguesve). Këta tregues duhet të shqyrtohen nga Institucionet e Kosovës, për të përcaktuar nëse dhe si duhet të pasqyrohen në mekanizmin e raportimit të Kosovës. Po kështu, për grupin përfundimtar të 53 treguesve (Aneksi 6), nuk ka të dhëna të disponueshme, dhe ato duhet të shqyrtohen për të përcaktuar nëse do të raportohen për Kosovën.



- Indikator i saktë i disponueshëm
- Të dhënat ekzistojnë por indikator i nuk kalkulohet
- Nuk ka të dhëna
- Indikator i përafërt i disponueshëm
- Të dhëna të përafërta të disponueshme / kalkuloohen pjesërisht
- Tier III / Jo relevante / Të tjera

4. Rekomandimet

Për t'i përdorur gjetjet e këtij raporti të Vlerësimit të Shpejtë të Integruar, janë zhvilluar rekomandimet e mëposhtme për përfshirjen dhe integrimin e mëtejshëm të OZHQ-ve në zhvillimin e strategjive dhe politikave, si dhe për ta rritur më tej disponueshmërinë e të dhënave që do të përdoren për të raportuar mbi treguesit e OZHQ-ve, në përputhje me metodologjinë dhe meta të dhënat (metadata) për OZHQ-të të dakorduara ndërkombëtarisht.

Këto rekomandime janë rezultat i një procesi të përbashkët dhe konsultativ me përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës. U mbajt një punëtori gjysmë ditore për të diskutuar dhe hartuar rekomandime specifike dhe të matshme që do të çohen më tej nga institucionet relevante për zbatim të mëtejshëm.

Në përputhje me përpjekjet e Kosovës për ta integruar agjendën e OZHQ-ve në nivelin qendror dhe lokal, dhe pas diskutimeve me institucionet relevante dhe palët e interesit, rekomandimet janë grupuar në tri kategori kryesore. Këto kategori pasqyrojnë drejtimet e punës me rëndësi kritike, të cilat kërkohen për ta avancuar punën e OZHQ-ve:

- Mekanizmat e avokimit dhe koordinimit për zbatimin dhe monitorimin e progresit të OZHQ-ve në përputhje me Rezolutën për OZHQ-të të miratuar në janar 2018;
- Përafrimi dhe integrimi i OZHQ-ve në kuadër të strategjive dhe politikave të zhvilluara rishtazi në nivelin qendror dhe lokal;

- Avancimi i përpjekjeve për të rritur disponueshmërinë e të dhënave në përputhje me metodologjinë ndërkombëtare për përcjelljen e progresit drejt OZHQ-ve.

Avokimi dhe koordinimi për zbatimin e Agjendës 2030

- Institucionet e Kosovës duhet të krijojnë mekanizma koordinues, duke përfshirë pikat e fokusit për secilin institucion, për zbatimin e OZHQ-ve dhe monitorimin e progresit, duke siguruar integrimin e OZHQ-ve në dokumentet strategjike dhe të politikave dhe përdorimin e të dhënave të disponueshme.
- Kuvendi duhet të shfrytëzojë rolin e tij legjislativ dhe të vazhdojë avokimin për OZHQ-të dhe zhvillimin e qëndrueshëm duke forcuar partneritetet me individë, institute studimore dhe organizata të shoqërisë civile, sektorin publik dhe privat, botën akademike dhe mediat, për të monitoruar zbatimin e Agjendës 2030.
- Kuvendi duhet t'i vlerësojë dhe përmirësojë kapacitetet aktuale të deputetëve të Kuvendit për t'u angazhuar dhe për të avokuar drejt arritjes së OZHQ-ve.

Përafrimi dhe integrimi i OZHQ-ve në kuadër të strategjive dhe dokumenteve të politikave

- Institucionet e Kosovës duhet të sigurojnë integrimin dhe përafrimin e Strategjisë së ardhshme Kombëtare për Zhvillim, strategjive sektoriale dhe

dokumente të tjera të politikave me synimet, treguesit dhe caqet e OZHQ-ve, duke siguruar etiketim adekuat për monitorim dhe raportim më të lehtë të progresit.

- Institucionet e Kosovës duhet të sigurojnë etiketim sistematik dhe adekuat për caqet dhe treguesit e OZHQ-ve në dokumentet e politikave dhe strategjive për të mundësuar monitorimin e progresit dhe për të kontribuar për Agjendën 2030 dhe OZHQ-të.

Rritja e disponueshmërisë së të dhënave në përputhje me metodologjinë ndërkombëtare për përcjelljen e progresit drejt Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve

- ASK-ja duhet t'i shqyrtojë treguesit që janë pjesërisht të disponueshëm apo ende jo të disponueshëm, për të përcaktuar pikat e hyrjes për mbledhjen e të dhënave dhe raportimin në kohën e duhur për këta tregues, për ta përsheptuar progresin drejt Agjendës 2030.
- ASK-ja dhe Institucionet e Kosovës duhet t'i përshtatin caqet dhe treguesit e OZHQ-ve me rrethanat lokale dhe t'i harmonizojnë me kërkesat e anëtarësimit në BE dhe prioritetet e Kosovës përmes një procesi të mbështetur në pronësi të fortë dhe që promovon pjesëmarrjen e të gjitha palëve relevante të interesit.
- ASK-ja duhet të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për të siguruar disponueshmërinë e të dhënave që

ende nuk janë të disponueshme, të cilat mund të llogariten dhe publikohen bazuar në informatat e zotëruara tashmë nga institucionet.

- ASK-ja duhet t'i konsolidojë në mënyrë sistematike treguesit e OZHQ-ve për të cilët tashmë mblidhen të dhëna në anketa dhe të dhëna administrative, si dhe të raportojë për progresin drejt tyre duke iu referuar treguesve specifikë të OZHQ-ve për referencë dhe përdorim të lehtë.
- ASK-ja duhet të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për gjenerimin e dëshmimeve.
- ASK-ja duhet të sigurojë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për gjenerimin e dëshmimeve.
- ASK-ja duhet të zhvillojë një metodologji e fuqishme për përcjelljen e progresit në zbatim dhe rezultateve kundrejt caqeve të BE-së dhe caqeve globale të OZHQ-ve, për të ndërtuar kapacitetin statistikor për mbështetjen e TI-së dhe mbledhjen e të dhënave, dhe, në fund të fundit, për ta realizuar Agjendën 2030.
- ASK-ja duhet të krijojë një bazë të të dhënave për OZHQ-të që është e lehtë për përdoruesit e ueb faqes së ASK-së, në mënyrë që të rritet përdorimi i të dhënave.

5. Annexes

TABELA 1: CAQET E OZHQ-VE TË PËRFSHIRA NË STRATEGJITË DHE DOKUMENTET E PLANIFIKIMIT TË KOSOVËS

	DOKUMENTI PLANIFIKUES	OZHQ CAQET
1	Plani i veprimt për rritjen e punësimit të të rinjve 2018-2020	4.5. Pabarazitë gjinore në arsim 8.5. Punësim i plotë 8.6. Papunësia e të rinjve
2	Agjencia për Planin Strategjik të Ndhmës Ligjore Falas (2015-2019)	16.3 Rendi dhe ligji
1.4 Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë burrat dhe gratë, në veçanti të varfërit dhe të cenueshmit, të kenë të drejta të barabarta për burimet ekonomike, si dhe qasje në shërbimet themelore, pronësinë dhe kontrollin mbi tokën dhe format e tjera të pronës, trashëgimisë, burimeve natyrore, teknologji të reja të përshtatshme dhe shërbime financiare, përfshirë mikrofinancën	1.4.1 Përqindja e popullsisë që jeton në amvisëri me qasje në shërbimet themelore	Metodologji komplekse e llogaritjes së treguesit, megjithatë disa të dhëna ekzistojnë në botime të ndryshme: ASK (qasja në teknologjinë e re), Anketa AKTSH 2019 (qasja në shërbimet themelore). Mungesa e të dhënave për qasjen në shërbimet financiare.
2.3 Deri në vitin 2030, të dyfishohet produktiviteti bujqësor dhe të hyrat e prodhuesve të vegjël ushqimorë, në veçanti të grave, popujve indigjenë, fermerëve familjarë, blegtorëve dhe peshkatarëve, duke përfshirë përmes qasjes së sigurt dhe të barabartë në tokë, burime dhe inpute të tjera prodhuese, njohuri, shërbime financiare, tregje dhe mundësi për shtimin e vlerës dhe punësim jo bujqësor	2.3.1 Vëllimi i prodhimit për njësi pune sipas klasave të madhësisë së ndërmarrjes bujqësore/blegtore/pyjore	Disa të dhëna për pronat bujqësore janë të disponueshme në ASK
	2.3.2 Të hyrat mesatare të prodhuesve të vegjël ushqimorë, sipas seksit dhe statusit indigjen	Mungesa e të dhënave për të hyrat e prodhuesve të vegjël ushqimorë, megjithatë disa të dhëna për prodhimin bujqësor mund të merren nga vegza e ASK-së më lart.
2.4 Deri në vitin 2030, të sigurohen sisteme të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit dhe të zbatohen praktika reziliente bujqësore që rrisin produktivitetin dhe prodhimin, që ndihmojnë në mirëmbajtjen e ekosistemeve, që forcojnë kapacitetin për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike, motit ekstrem, thatësisë, përmytjeve dhe fatkeqësive të tjera, dhe që e përmirësojnë progresisht tokën dhe cilësinë e dherave	2.4.1 Përqindja e zonës bujqësore nën bujqësinë prodhuese dhe të qëndrueshme	Disa të dhëna për sipërfaqen e tokës bujqësore janë në dispozicion në ASK

CAKU	TREGUESI	SHËNIME
<p>2.a Të rriten investimet, përfshirë përmes bashkëpunimit të zgjeruar ndërkombëtar, në infrastrukturën rurale, hulumtimin dhe zgjerimin e shërbimeve bujqësore, zhvillimin e teknologjisë dhe bankave të gjeneve të bimëve dhe bagëtisë, në mënyrë që të rritet kapaciteti prodhues bujqësor në vendet në zhvillim, veçanërisht vendet më pak të zhvilluara</p>	<p>2.a.1 Indeksi i orientimit bujqësor për shpenzimet qeveritare</p>	<p>Të dhëna të disponueshme për shpenzimet publike drejt bujqësisë</p>
	<p>2.a.2 Flukset totale zyrtare (ndihma zyrtare zhvillimore plus flukset e tjera zyrtare) në sektorin e bujqësisë</p>	<p>Ministria e Integrimit Evropian raporton se janë shpenzuar 106.3 milionë euro në sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (BZHR) gjatë periudhës 2018-2015.</p>
<p>3.8 Të arrihet mbulimi shëndetësor universal, përfshirë mbrojtjen nga risku financiar, qasja në shërbime cilësore thelbësore të kujdesit shëndetësor dhe qasja në barna dhe vaksina thelbësore, efektive, cilësore dhe të përballueshme për të gjithë</p>	<p>3.8.1 Të mbulohen shërbimet thelbësore shëndetësore (përcaktuar si mbulimi mesatar i shërbimeve thelbësore bazuar në intervenimet gjurmuese që përfshijnë shëndetin riprodhues, të lehonave, të porsalindurve dhe fëmijëve, sëmundjet ngjitëse, sëmundjet jo-ngjitëse dhe kapacitetin e shërbimit dhe qasjen, në mesin e popullsisë së përgjithshme dhe popullsisë më të pafavorizuar)</p>	<p>Disa të dhëna janë në dispozicion, por metodologjia e llogaritjes është komplekse dhe disa nga të dhënat do të vijnë nga AKTSH 6.</p>
	<p>3.8.2 Përqindja e popullsisë me shpenzime të mëdha shtëpiake për shëndetin si pjesë e shpenzimeve totale të familjes ose të hyrave</p>	<p>Të dhënat e anketës: Bazuar në Anketën e Buxhetit të Amvisërive (ASK), në vitin 2017 shpenzimet e familjeve për shëndetësinë ishin 265 euro (Urban 252 euro/Rural 274 euro)</p>
<p>3.b Të mbështetet hulumtimi dhe zhvillimi i vaksinave dhe barnave për sëmundjet ngjitëse dhe jo-ngjitëse që prekin kryesisht vendet në zhvillim, të sigurohet qasje në barna dhe vaksina thelbësore të përballueshme, në përputhje me Deklaratën e Dohas mbi Marrëveshjen TRIPS dhe Shëndetin Publik, e cila afirmon të drejtën e vendeve në zhvillim për t'i përdorur plotësisht dispozitat në Marrëveshjen për Aspektet e ndërlidhura me Tregtinë të të drejtave të pronësisë intelektuale në lidhje me fleksibilitetin për të mbrojtur shëndetin publik, dhe, në veçanti, të sigurohet qasje në barna për të gjithë</p>	<p>3.b.3 Përqindja e objekteve shëndetësore që kanë një grup kryesor të barnave relevante thelbësore të disponueshme dhe të përballueshme në baza të qëndrueshme</p>	<p>Nuk ka të dhëna të disponueshme në anglisht. Mundësia për të nxjerrë informacionin relevant nga ASK-ja</p>
<p>4.3 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje e barabartë për të gjitha gratë dhe burrat në arsim teknik, profesional dhe terciar të përballueshëm dhe cilësor, përfshirë universitetin</p>	<p>4.3.1 Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve dhe të rriturve në arsimin dhe trajnimin formal dhe joformal në 12 muajt e mëparshëm, sipas seksit</p>	<p>Të dhënat e anketës: Treguesi i përafërt për këtë tregues të OZHQ-ve mund të jetë "Pjesëmarrja e të Rriturve (25-64 vjeç) në të nxënët gjatë gjithë jetës", e cila mund të llogaritet nga AFP-ja.</p>
<p>4.a Të ndërtohen dhe përmirësohen objekte arsimore që janë të ndjeshme ndaj fëmijëve, aftësisë së kufizuar dhe gjinisë, dhe sigurojnë mjedise të sigurta, jo të dhunshme, gjithëpërfshirëse dhe efektive të të nxënët për të gjithë</p>	<p>4.a.1 Përqindja e shkollave me qasje në (a) energji elektrike; (b) internet për qëllime pedagogjike; (c) kompjuterë për qëllime pedagogjike; (d) infrastrukturë dhe materiale të adaptuara për nxënësit me aftësi të kufizuara; (e) uji i pijshëm bazë; (f) objektet higjienike themelore për secilin seks më vete; dhe (g) pajisjet themelore të larjes së duarve (sipas përcaktimeve të treguesit WASH)</p>	<p>Disa të dhëna janë në dispozicion në MASHT/SMIA</p>

CAKU	TREGUESI	SHËNIME
5.1 T'u jepet fund të gjitha formave të diskriminimit ndaj të gjitha grave dhe vajzave kudo që ndodhen	5.1.1 Pavarësisht nëse ekzistojnë apo jo kornizat ligjore, të promovohet, zbatohet dhe monitorohet barazia dhe jo diskriminimi në bazë të seksit	Metodologjia komplekse kërkon që të dhënat të mblidhen së pari përmes pyetësorëve të anketës nga Zyrat Kombëtare të Statistikave, Mekanizmat Kombëtare të Grave dhe praktikuesit ligjorë/studuesit e barazisë gjinore
5.2 Të eliminohen të gjitha format e dhunës kundër të gjitha grave dhe vajzave në sferat publike dhe private, duke përfshirë trafikimin dhe shfrytëzimin seksual dhe lloje të tjera të shfrytëzimit.	5.2.1 Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15 vjeç e lart me partner, të nënshtruara ndaj dhunës fizike, seksuale ose psikologjike nga një partner aktual ose ish partner intim në 12 muajt e mëparshëm, sipas formës së dhunës dhe sipas moshës	Të dhënat e administratorit në formën e një baze të të dhënave DV do të jenë të disponueshme në vitet e ardhshme, por ato nuk mund të përdoren pasi që janë të dhëna të incidencës dhe jo të dhëna të prevalencës (të cilat do të duhej të vinin nga një studim kombëtar ose ndërkombëtar i familjeve)
	5.2.2 Përqindja e grave dhe vajzave të moshës 15 vjeç e lart, të nënshtruara ndaj dhunës seksuale nga persona të tjerë përveç partnerit intim në 12 muajt e mëparshëm, sipas moshës dhe vendit të ndodhjes	Të dhënat e administratorit në formën e një baze të të dhënave DV do të jenë të disponueshme në vitet e ardhshme, por ato nuk mund të përdoren pasi që janë të dhëna të incidencës dhe jo të dhëna të prevalencës (të cilat do të duhej të vinin nga një studim kombëtar ose ndërkombëtar i familjeve)
5.6 Të sigurohet qasja universal në shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat riprodhuese siç është rënë dakord në përputhje me Programin e Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe Platformën e Veprimit të Pekinit dhe dokumentet e rezultateve të konferencave të tyre të rishikimit	5.6.1 Përqindja e grave të moshës 15-49 vjeç që marrin vendimet e tyre të informuara në lidhje me marrëdhëniet seksuale, përdorimin e kontraceptivëve dhe kujdesin shëndetësor riprodhues	Anketa e Shëndetit demografik (ASHD) 2009 jep vetëm informacion mbi autonominë e grave në vendimmarrje për përdorimin e kontraceptivëve.
	5.6.2 Numri i vendeve me ligje dhe rregullore që garantojnë qasje të plotë dhe të barabartë për gratë dhe burrat e moshës 15 vjeç e lart në kujdesin shëndetësor, informacionin dhe edukimin seksual dhe riprodhues	Nuk ka të dhëna të disponueshme të kohëve të fundit.
5.c Të miratohen dhe të forcohen politikat e shëndosha dhe legjislatoni i zbatueshëm për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave në të gjitha nivelet	5.c.1 Përqindja e vendeve me sisteme për të gjurmuar dhe bërë alokime publike për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mbledh dhe publikon të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë për subvencionet bujqësore; Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbledh dhe publikon të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë për subvencione të projekteve kulturore dhe sportive të financuara; dhe komunat ofrojnë informata për stafin, trajnimet dhe buxhetin e alokuar për subvencione. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale mbledh të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë për përfituesit e pensioneve të komuniteteve të ndryshme, përfshirë financimin e strehimoreve. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë mbledh të dhëna të zbërthyer sipas gjinisë për grante për studime të IHD-ve, si dhe për hulumtime të bazuara në gjini

CAKU	TREGUESI	SHËNIME
6.5 Deri në vitin 2030, të zbatohet menaxhimi i integruar i burimeve ujore në të gjitha nivelet, përfshirë përmes bashkëpunimit ndërkufitar, siç është e përshtatshme	6.5.2 Përqindja e zonës së pellgut ndërkufitar me një marrëveshje operationale për bashkëpunimin për ujërat	Të dhënat janë në dispozicion në Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM), por treguesi i saktë nuk është llogaritur: Ka sisa informacione në 'Perspektivën e Sigurisë së Ujërave në Kosovë', megjithatë mungojnë të dhënat sasiore
6.6 Deri në vitin 2020, të mbrohen dhe sanohen ekosistemet e lidhura me ujin, duke përfshirë malet, pyjet, ligatinat, lumenjtë, ujëmbajtësit dhe liqenet	6.6.1 Ndryshimi në shtrirjen e ekosistemeve të lidhura me ujin me kalimin e kohës	ASK-ja siguron informacion mbi ndryshimet në ekosistemet e lidhura me ujin (p.sh. furnizimi me ujë të pijshëm, ujërat e humbura, etj.)
7.3 Deri në vitin 2030, të dyfishohet niveli global i përmirësimit të efijencës së energjisë	7.3.1 Intensiteti i energjisë i matur në terma të energjisë primare dhe BPV-së	Treguesi nuk është llogaritur për BPV-në, gjithashtu nuk ka të dhëna të disponueshme për nivelin fillestar, vetëm caku specifik është i disponueshëm (për vitin 2018), mund të llogaritet tashmë, por nuk ka përditësim për këtë
8.5 Deri në vitin 2030, të arrihet punësim i plotë dhe produktiv dhe punë e denjë për të gjitha gratë dhe burrat, përfshirë të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara, dhe pagë e barabartë për punë me vlerë të barabartë	8.5.1 Fitimet mesatare në orë të të punësuarave femra dhe atyre meshkuj, sipas profesionit, moshës dhe personave me aftësi të kufizuara	Informacion i pamjaftueshëm për treguesin
9.1 Të zhvillohet një infrastrukturë cilësore, të besueshme, të qëndrueshme dhe reziliente, përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien njerëzore, me një fokus në qasje të përballueshme dhe të barabartë për të gjithë	9.1.1 Përqindja e popullsisë rurale që jeton brenda 2 km të një rruge të kalueshme në të gjitha stinët	Treguesi mund të llogaritet pjesërisht nga kombinimi i kërkesave të të dhënave të metodologjisë së llogaritjes, megjithatë shifrat duhet të përditësohen (p.sh. shpërndarja e popullsisë, vendndodhja e rrugës dhe gjendja): ASK, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit.
9.4 Deri në vitin 2030, të përmirësohet infrastruktura dhe të rindërtohen industritë për t'i bërë ato të qëndrueshme, me rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve dhe adoptimin më të madh të teknologjive mjedisore dhe proceseve industriale të pastra dhe të shëndosha, me të gjitha vendet që ndërmarrin veprime në përputhje me aftësitë e tyre përkatëse	9.4.1 Emetimet e CO2 për njësi të vlerës së shtuar	1. Ajri: Prioriteti: Parandalimi dhe zvogëlimi i emetimeve të dëmshme në ajër
10.7 Të lehtësohet migracioni dhe lëvizshmëria e organizuar, e sigurt, e rregullt dhe e përgjegjshme e njerëzve, përfshirë përmes zbatimit të politikave të planifikuara dhe të menaxhuara mirë të migracionit	10.7.1 Kostoja e rekrutimit që përballohet nga i punësuar si pjesë e të hyrave vjetore të fituara në vendin e destinacionit	Nuk ka të dhëna të disponueshme. ASK tregon se 8% e të hyrave të familjeve vijnë nga remitancat, megjithatë vetëm kjo shifër nuk mund të përmbushë kërkesat për ta llogaritur treguesin.
	10.7.2 Numri i vendeve që kanë zbatuar politika migrimi të menaxhuara mirë	Strategjia Shtetërore për Planin e Veprimit për Migracionin 2013-2018

CAKU	TREGUESI	SHËNIME
<p>12.c Të racionalizohen subvencionet joefikase të karburanteve fosile që inkurajojnë konsum shpërdorues duke hequr shtrembërimet e tregut, në përputhje me rrethanat kombëtare, duke përfshirë ristrukturimin e tatimit dhe heqjen gradualisht të atyre subvencioneve të dëmshme, aty ku ato ekzistojnë, për të pasqyruar ndikimet e tyre në mjedis, duke marrë plotësisht parasysh nevojat dhe kushtet specifike të vendeve në zhvillim dhe duke i minimizuar ndikimet e mundshme negative në zhvillimin e tyre në një mënyrë që mbron të varfërit dhe komunitetet e prekura</p>	<p>12.c.1 Shuma e subvencioneve për karburante fosile për njësi të BPV-së (prodhimi dhe konsumi) dhe si përqindje e shpenzimeve totale kombëtare për lëndët djegëse fosile</p>	<p>Nuk ka të dhëna të disponueshme të kohëve të fundit.</p>
<p>13.1 Të forcohet rezilienca dhe aftësia përshtatëse ndaj rreziqeve dhe fatkeqësive natyrore të lidhura me klimën në të gjitha vendet</p>	<p>13.1.2 Numri i vendeve që miratojnë dhe zbatojnë strategjitë kombëtare të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë në përputhje me Kornizën Sendai për Reduktimin e Rrezikut të Fatkeqësive 2015-2030</p>	<p>Njësoj si treguesit 1.5.1 dhe 11.5.1 Treguesi është për raportimin rajonal/global Mungon informacioni mbi raportin e monitorimit të zbatimit të strategjisë. Kosova mund të llogaritet, por treguesi është në nivelin global</p>
	<p>13.1.3 Përqindja e qeverisjeve lokale që miratojnë dhe zbatojnë strategjitë lokale të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë në përputhje me strategjitë kombëtare të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë</p>	<p>Kërkohet informacion shtesë</p>
	<p>13.2.1 Numri i vendeve që kanë komunikuar krijimin ose funksionalizimin e një politike/strategjie/plani të integruar i cili rrit aftësinë e tyre për t'u përshtatur me ndikimet e pafavorshme të ndryshimit të klimës, dhe nxit reziliencën ndaj klimës dhe zhvillimin me emetime të ulëta të gazrave serë në një mënyrë që bën të mos kërcënojë prodhimin ushqimor (përfshirë një plan kombëtar të përshtatjes, kontribut të përcaktuar në shkallë nacionale, komunikim kombëtar, raport përditësimi dyvjeçar ose të tjera)</p>	<p>Të dhënat do të raportohen përmes Kornizës së Bashkëpunimit të OKB-së nga Raporti Vjetor i Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe Raporti i Linjës Fundore (Projekti) i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Kosovës.</p>
<p>15.2 Deri në vitin 2020, të promovohet zbatimi i menaxhimit të qëndrueshëm të të gjitha llojeve të pyjeve, të ndalohet prerja e pyjeve, të sanohen pyjet e degraduara dhe të rriten ndjeshëm pyllëzimet dhe ripyllëzimet globalisht</p>	<p>15.2.1 Progresi drejt menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve</p>	<p>Ky është tregues pa të dhëna. Sidoqoftë, ka progres drejt menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve (siç shihet në strategjitë kombëtare dhe planet e veprimt; p.sh. në Strategjinë Mjedisore të Kosovës (SMK) 2013 - 2022)</p>
<p>15.3 Deri në vitin 2030, të luftohet shkretëtirëzimin, të sanohet toka dhe dherat e degraduara, duke përfshirë tokën e prekur nga shkretëtirëzimi, thatësira dhe përmbytjet, dhe të bëhen përpjekje të arrihet një botë neutrale ndaj degradimit të tokës</p>	<p>15.3.1 Përqindja e tokës që është degraduar kundrejt sipërfaqes totale të tokës</p>	<p>Nuk ka të dhëna të disponueshme për publikun, një raport flet vetëm për % të pyjeve të degraduara (20% në vitin 2010 - Plani Hapësinor i Kosovës 2010 - 2020+)</p>

CAKU	TREGUESI	SHËNIME
16.1 Të ulen ndjeshëm të gjitha format e dhunës dhe shkalla e vdekjeve që lidhen me to kudo	16.1.3 Përqindja e popullsisë që i është nënshtruar (a) dhunës fizike, (b) dhunës psikologjike dhe (c) dhunës seksuale në 12 muajt e mëparshëm	Kërkohet informacion shtesë dhe përcjellje me qeverinë
16.2 T'i jepet fund abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe torturës kundër fëmijëve	16.2.2 Numri i viktimave të trafikimit njerëzor për 100,000 banorë, sipas seksit, moshës dhe formës së shfrytëzimit	Kërkohet informacion shtesë dhe përcjellje me qeverinë
	16.2.3 Përqindja e grave dhe burrave të rinj të moshës 18-29 vjeç që kanë përjetuar dhunë seksuale deri në moshën 18 vjeç	Kërkohet informacion shtesë dhe përcjellje me qeverinë
16.3 Të promovohet sundimi i ligjit në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të sigurohet qasje e barabartë në drejtësi për të gjithë	16.3.1 Përqindja e viktimave të dhunës në 12 muajt e mëparshëm të cilët e raportuan viktimizimin e tyre tek autoritetet kompetente ose mekanizmat e tjerë të njohur zyrtarisht për zgjidhjen e konflikteve	Kërkohet informacion shtesë dhe përcjellje me qeverinë
16.5 Të ulen ndjeshëm korrupsioni dhe ryshfeti në të gjitha format e tyre	16.5.2 Përqindja e bizneseve të cilët kishin të paktën një kontakt me një zyrtar publik dhe që i kanë paguar ryshfet një zyrtari publik, ose që u ishte kërkuar ryshfet nga ata zyrtarë publikë gjatë 12 muajve të mëparshëm	Të dhënat e anketës: Vlerësimi i Korrupsionit në Kosovë 2016 (Riinvest & SELDI) % e të anketuarve që besojnë se shumica ose të gjithë zyrtarët në fjalë janë të përfshirë në korrupsion
16.10 Të sigurohet qasja e publikut në informacion dhe të mbrohen liritë themelore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare	16.10.2 Numri i vendeve që miratojnë dhe zbatojnë garancitë kushtetuese, ligjore dhe/ose të politikave për qasjen e publikut në informacion	Preferohet konfirmimi nga BB
16.a Të forcohen institucionet relevante kombëtare, duke përfshirë përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, për ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin.	16.a.1 Ekzistenca e institucioneve të pavarura kombëtare të të drejtave të njeriut në përputhje me Parimet e Parisit	Institucionet e pavarura kombëtare të të drejtave të njeriut në përputhje me Parimet e Parisit ekzistojnë, por nuk mund të akreditohen nga GANHRI nën OHCHR për shkak të statusit të Kosovës Public Pulse data

TABELA 7: TREGUESIT PËR TË CILËT TË DHËNAT NUK JANË TË DISPONUESHME

CAKU	TREGUESI
1.5 Deri në vitin 2030, të ndërtohet reziliencia e të varfërve dhe personave në situata të cenueshme dhe të zvogëlohet ekspozimi dhe cenueshmëria e tyre ndaj ngjarjeve ekstreme të lidhura me klimën dhe goditjeve dhe fatkeqësive të tjera ekonomike, sociale dhe mjedisore	1.5.4 Përqindja e qeverisjeve lokale që miratojnë dhe zbatojnë strategjitë lokale të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë në përputhje me strategjitë kombëtare të zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë
2.1 Deri në vitin 2030, t'i jepet fund urisë dhe të sigurohet qasja për të gjithë njerëzit, veçanërisht të varfërit dhe njerëzit në situata të cenueshme, përfshirë foshnjat, në ushqim të sigurt, ushqyes dhe të mjaftueshëm gjatë gjithë vitit	2.1.1 Prevalenca e nënushqyerjes
	2.1.2 Prevalenca e pasigurisë së moderuar ose të rëndë ushqimore në popullatë, bazuar në Shkallën e Përjetimit të Pasigurisë Ushqimore (FIES)
2.5 Deri në vitin 2020, të ruhet diversiteti gjenetik i farërave, bimëve të kultivuara dhe bagëtive dhe specieve të egra të lidhura me to, duke përfshirë përmes bankave të farërave dhe bimëve të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme dhe të larmishme në nivelet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, dhe të promovohet qasja në ndarja e drejtë e përfitimeve që vijnë nga shfrytëzimi i burimeve gjenetike dhe njohurive të lidhura tradicionale, siç është rënë dakord ndërkombëtarisht	2.5.1 Numri i burimeve gjenetike bimore dhe shtazore për ushqim dhe bujqësi të siguruar në mjediset e ruajtjes afatmesme ose afatgjata
	2.5.2 Përqindja e racave lokale të klasifikuara si të rrezikuara, jo të rrezikuara ose në një nivel të panjohur të rrezikut të zhdukjes
2.b Të korrigojen dhe parandalohen kufizimet dhe shtrembërimet tregtare në tregjet botërore bujqësore, duke përfshirë përmes eliminimit paralel të të gjitha formave të subvencioneve të eksportit bujqësor dhe të gjitha masave të eksportit me efekt ekuivalent, në përputhje me mandatin e Raundit të Zhvillimit të Dohas	2.b.1 Subvencionet e eksportit bujqësor
2.c Të miratohen masa për të siguruar funksionimin e duhur të tregjeve të produkteve ushqimore dhe derivateve të tyre dhe për të lehtësuar qasjen në kohë në informacionin e tregut, duke përfshirë edhe rezervat ushqimore, në mënyrë që të ndihmohet në kufizimin e paqëndrueshmërisë ekstreme të çmimeve të ushqimeve	2.c.1 Treguesi i anomalive të çmimeve të ushqimeve
3.1 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet shkalla globale e vdekshmërisë së lehonave në më pak se 70 për 100,000 lindje të gjalla	3.1.1 Raporti i vdekshmërisë së lehonave
3.5 Të forcohet parandalimi dhe trajtimi i abuzimit me substanca, duke përfshirë abuzimin me narkotikë dhe përdorimin e dëmshëm të alkoolit	3.5.2 Përdorimi i dëmshëm i alkoolit, i përcaktuar në kontekstin kombëtar si konsumimi i alkoolit për kokë (mosha 15 vjeç e lart) brenda një viti kalendarik në litra alkool të pastër
3.9 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndjeshëm numri i vdekjeve dhe sëmundjeve nga kimikatet e rrezikshme dhe ndotja dhe kontaminimi i ajrit, ujit dhe tokës	3.9.1 Shkalla e vdekshmërisë që i atribuohet ndotjes së ajrit në amvisëri dhe mjedis

CAKU	TREGUESI
	<p>3.9.2 Shkalla e vdekshmërisë që i atribuohet ujit të pasigurt, kanalizimeve të pasigurta dhe mungesës së higjienës (ekspozimi ndaj shërbimeve të pasigurta të ujit, sanitarisë dhe higjienës për të gjithë (WASH))</p> <p>3.9.3 Shkalla e vdekshmërisë që i atribuohet helmimit të paqëllimtë</p>
<p>3.b Të mbështetet hulumtimi dhe zhvillimi i vaksinave dhe barnave për sëmundjet ngjitëse dhe jo-ngjitëse që prekin kryesisht vendet në zhvillim, të sigurohet qasje në barna dhe vakcina thelbësore të përballueshme, në përputhje me Deklaratën e Dohas mbi Marrëveshjen TRIPS dhe Shëndetin Publik, e cila afirmon të drejtën e vendeve në zhvillim për t'i përdorur plotësisht dispozitat në Marrëveshjen për Aspektet e ndërlidhura me Tregtinë të të drejtave të pronësisë intelektuale në lidhje me fleksibilitetin për të mbrojtur shëndetin publik, dhe, në veçanti, të sigurohet qasje në barna për të gjithë</p>	<p>3.b.2 Ndihma totale neto zhvillimore zyrtare për hulumtimet mjekësore dhe sektorët bazë të shëndetësisë</p>
<p>3.d Të forcohet kapaciteti i të gjitha vendeve, veçanërisht vendeve në zhvillim, për paralajmërimin e hershëm, uljen e risqeve dhe menaxhimin e risqeve shëndetësore kombëtare dhe globale</p>	<p>3.d.1 Kapaciteti i Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetësisë (RRNSH) dhe gatishmëria për emergjenca shëndetësore</p>
<p>4.b Deri në vitin 2020, të zgjerohet në mënyrë thelbësore globale numri i bursave në dispozicion për vendet në zhvillim, veçanërisht vendet më pak të zhvilluara, shtetet e vogla ishullore në zhvillim dhe vendet afrikane, për regjistrim në arsimin e lartë, përfshirë trajnimin profesional dhe teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, programe teknike, inxhinierike dhe shkencore, në vendet e zhvilluara dhe vendet e tjera në zhvillim</p>	<p>4.b.1 Vëllimi i flukseve zyrtare të ndihmës zhvillimore për bursa sipas sektorit dhe llojit të studimit</p>
<p>5.4 T[njihet dhe vlerësohet kujdesi i papaguar dhe puna në amvisëri përmes ofrimit të shërbimeve publike, infrastrukturës dhe politikave të mbrojtjes sociale dhe promovimit të përgjegjësisë së përbashkët brenda amvisërisë dhe familjes, siç është e përshtatshme në shkallë vendi</p>	<p>5.4.1 Përqindja e kohës së kaluar në punë të papaguara në shtëpi dhe kujdes, sipas seksit, moshës dhe vendndodhjes</p>
<p>5.a Të ndërmerren reforma për t'u dhënë grave të drejta të barabarta në burimet ekonomike, si dhe qasje në pronësi dhe kontroll mbi tokën dhe format e tjera të pronës, shërbimeve financiare, trashëgimisë dhe burimeve natyrore në përputhje me ligjet kombëtare</p>	<p>5.a.2 Përqindja e vendeve ku korniza ligjore (përfshirë ligjin zakonor) garanton të drejtat e barabarta të grave për pronësinë dhe/ose kontrollin e tokës</p>
<p>6.3 Deri në vitin 2030, të përmirësohet cilësia e ujërave duke zvogëluar ndotjen, duke eliminuar deponimin e paligjshëm dhe duke e minimizuar çlirimin e kimikateve dhe materialeve të rrezikshëm, duke përgjysmuar përqindjen e ujërave të zeza të patrajtuara, dhe duke rritur në mënyrë të konsiderueshme riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt globalisht</p>	<p>6.3.1 Përqindja e ujërave të ndotura të trajtuara në mënyrë të sigurt</p> <p>6.3.2 Përqindja e trupave ujqorë me cilësi të mirë të ujit në ambient</p>
<p>6.4 Deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm efikasiteti i përdorimit të ujërave në të gjithë sektorët dhe të sigurohet tërheqje dhe furnizim i qëndrueshëm me ujë të ëmbël për të adresuar mungesën e ujit dhe për të zvogëluar ndjeshëm numrin e njerëzve që vuajnë nga mungesa e ujit</p>	<p>6.4.1 Ndryshimi i efikasitetit të përdorimit të ujërave me kalimin e kohës</p> <p>6.4.2 Niveli i stresit ujqor: tërheqja e ujërave të ëmbla si pjesë e burimeve të disponueshme të ujërave të ëmbla</p>

CAKU	TREGUESI
6.5 Deri në vitin 2030, të zbatohet menaxhimi i integruar i burimeve ujore në të gjitha nivelet, përfshirë përmes bashkëpunimit ndërkufitar, siç është e përshtatshme	6.5.1 Shkalla e zbatimit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore (0–100)
6.a Deri në vitin 2030, të zgjerohet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetja për ndërtimin e kapaciteteve për vendet në zhvillim në aktivitetet dhe programet e lidhura me ujin dhe kanalizimet, duke përfshirë shfrytëzimin e ujërave, shkripëzimin, efikasitetin e ujërave, trajtimin e ujërave të ndotura, teknologjitë e riciklimit dhe ripërdorimit	6.a.1 Sasia e ndihmës zyrtare zhvillimore të lidhur me ujërat dhe kanalizimet që është pjesë e një plani shpenzimesh të koordinuara nga qeveria
6.b Të mbështetet dhe të forcohet pjesëmarrja e komuniteteve lokale në përmirësimin e menaxhimit të ujërave dhe kanalizimeve	6.b.1 Përqindja e njësive administrative lokale me politika dhe procedura të vendosura dhe operacionale për pjesëmarrjen e komuniteteve lokale në menaxhimin e ujërave dhe kanalizimeve
7.a Deri në vitin 2030, të forcohet bashkëpunimi ndërkombëtar për të lehtësuar qasjen në hulumtime dhe teknologjinë e energjisë së pastër, duke përfshirë energjinë e ripërtërishme, efikasitetin e energjisë dhe teknologjinë e përpunuar dhe më të pastër të karburanteve fosile, dhe të promovohen investime në infrastrukturën e energjisë dhe teknologjinë e energjisë së pastër	7.a.1 Flukset financiare ndërkombëtare në vendet në zhvillim në mbështetje të hulumtimit dhe zhvillimit të energjisë së pastër dhe prodhimit të energjisë së ripërtërishme, përfshirë këtu edhe sistemet hibride
8.4 Të përmirësohet në mënyrë progresive, deri në vitin 2030, eficientia globale e burimeve në konsum dhe prodhim, dhe të bëhen përpjekje të shkëputet rritja ekonomike nga degradimi i mjedisit, në përputhje me Kornizën 10-vjeçare të Programeve për Konsumimin dhe Prodhimin e Qëndrueshëm, me udhëheqjen e vendeve të zhvilluara	8.4.1 Gjurma materiale, gjurma materiale për kokë, dhe gjurma materiale për BPV
	8.4.2 Konsumi vendor i materialeve, konsumi vendor i materialeve për kokë, dhe konsumi vendor i materialeve për BPV
8.a Të rritet Ndihma për Mbështetjen e Tregtisë për vendet në zhvillim, veçanërisht vendet më pak të zhvilluara, përfshirë përmes Kornizës së Integruar të Zgjeruar për Ndihmën Teknike në lidhje me Tregtinë për Vendet më pak të Zhvilluara	8.a.1 Zotimet dhe disbursimet e Ndihmës për Tregtinë
9.1 Të zhvillohet një infrastrukturë cilësore, të besueshme, të qëndrueshme dhe reziliente, përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien njerëzore, me një fokus në qasje të përbalueshme dhe të barabartë për të gjithë	9.1.2 Volumet e pasagjerëve dhe të mallrave, sipas mënyrës së transportit
9.2 Të promovohet industrializimi gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm dhe, deri në vitin 2030, të rritet ndjeshëm pjesa e industrisë në punësim dhe bruto prodhimin vendor, në përputhje me rrethanat kombëtare, dhe të dyfishohet pjesa e saj në vendet më pak të zhvilluara	9.2.2 Punësimi në prodhim si pjesë e punësimit total
9.3 Të rritet qasja e ndërmarrjeve të vogla dhe industriale, veçanërisht në vendet në zhvillim, në shërbimet financiare, përfshirë kreditë e përbalueshme, dhe të bëhet integrimi i tyre në zinxhirët e vlerës dhe tregjet	9.3.1 Përqindja e industrive në shkallë të vogël në totalin e vlerës së shtuar të industrisë
	9.3.2 Përqindja e industrive në shkallë të vogël me hua ose linjë kredie

CAKU	TREGUESI
<p>9.5 Të përmirësohet hulumtimi shkencor, të përmirësohen aftësitë teknologjike të sektorëve industriale në të gjitha vendet, në veçanti në vendet në zhvillim, duke përfshirë, deri në vitin 2030, inkurajimin e inovacionit dhe rritjen e konsiderueshme të numrit të punëtorëve të hulumtimit dhe zhvillimit për 1 milion banorë, si dhe shpenzimet publike dhe private për hulumtim dhe zhvillim</p>	<p>9.5.1 Shpenzimet për hulumtim dhe zhvillim si përqindje e BPV-së</p> <p>9.5.2 Hulumtuesit (ekuivalent me orar të plotë) për milion banorë</p>
<p>9.a Të lehtësohet zhvillimi i qëndrueshëm dhe rezilient i infrastrukturës në vendet në zhvillim përmes mbështetjes së zgjeruar financiare, teknologjike dhe teknike për vendet afrikane, vendet më pak të zhvilluara, vendet në zhvillim pa dalje në det, dhe shtetet e vogla ishullore në zhvillim</p>	<p>9.a.1 Mbështetja totale zyrtare ndërkombëtare (ndihma zyrtare zhvillimore plus flukse të tjera zyrtare) në infrastrukturë</p>
<p>9.b Të mbështetet zhvillimi vendor i teknologjisë, hulumtimi dhe inovacioni në vendet në zhvillim, duke përfshirë sigurimin e një mjedisi me politika të favorshëm për, ndër të tjera, diversifikimin industrial dhe shtimin e vlerës së mallrave</p>	<p>9.b.1 Përqindja e vlerës së shtuar të industrisë së teknologjisë së mesme dhe të lartë në vlerën totale të shtuar</p>
<p>10.1 Deri në vitin 2030, në mënyrë progresive të arrihet dhe të mbahet rritja e të hyrave e 40 përqindëshit të poshtëm të popullsisë në një shkallë më të lartë se mesatarja kombëtare</p>	<p>10.1.1 Shkalla e rritjes së shpenzimeve familjare ose të hyrave për kokë ndërmjet 40 përqindëshit të popullsisë të popullsisë dhe popullsisë totale</p>
<p>10.4 Të miratohen politika, posaçërisht politikat fiskale, të pagave dhe mbrojtjes sociale, dhe progresivisht të arrihet barazi më e madhe</p>	<p>10.4.1 Pjesa e punës në BPV, që përfshin pagat dhe transferet e mbrojtjes sociale</p>
<p>10.a Të zbatohet parimi i trajtimit të veçantë dhe të diferencuar për vendet në zhvillim, veçanërisht vendet më pak të zhvilluara, në përputhje me marrëveshjet e Organizatës Botërore të Tregtisë</p>	<p>10.a.1 Përqindja e linjave tarifore të aplikuara për importet me tarifë zero nga vendet më pak të zhvilluara dhe vendet në zhvillim</p>
<p>11.2 Deri në vitin 2030, të sigurohet qasje në sistemet e transportit të sigurt, të përbalueshëm, të qasshëm dhe të qëndrueshëm për të gjithë, duke përmirësuar sigurinë rrugore, veçanërisht duke zgjeruar transportin publik, me vëmendje të veçantë për nevojat e personave në situata të cenueshme, grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, dhe më të moshuarve</p>	<p>11.2.1 Përqindja e popullsisë që ka qasje të përshtatshme në transportin publik, sipas seksit, moshës dhe personave me aftësi të kufizuara</p>
<p>12.2 Deri në vitin 2030, të arrihet menaxhimi i qëndrueshëm dhe përdorimi efikas i burimeve natyrore</p>	<p>12.2.1 Gjurma materiale, gjurma materiale për kokë, dhe gjurma materiale për BPV</p>
<p>12.6 Të inkurajohen kompanitë, posaçërisht kompanitë e mëdha dhe transnacionale, që të miratojnë praktika të qëndrueshme dhe të integrojnë informacionin e qëndrueshmërisë në ciklin e tyre të raportimit</p>	<p>12.6.1 Numri i kompanive që publikojnë raporte të qëndrueshmërisë</p>

CAKU	TREGUESI
<p>14.4 Deri në vitin 2020, të rregullohet në mënyrë efektive shfrytëzimi dhe t'i jepet fund peshkimit të tepruar, peshkimit të paligjshëm, të pareportuar dhe të parregulluar dhe praktikave shkatërruese të peshkimit, dhe të zbatohen planet e menaxhimit të bazuara në shkencë, në mënyrë që të rimëkëmben rezervat e peshkut në kohën më të shkurtër të mundshme, të paktën në nivele që mund të prodhojnë rendimente maksimalisht të qëndrueshme, siç përcaktohet nga karakteristikat e tyre biologjike</p>	<p>14.4.1 Përqindja e rezervave të peshkut brenda niveleve të qëndrueshme biologjikisht</p>
<p>14.6 Deri në vitin 2020, të ndalohen forma të caktuara të subvencioneve të peshkimit që kontribuojnë në kapacitetin e tepërt dhe peshkimin e tepruar, të eliminohen subvencionet që kontribuojnë në peshkim të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar, dhe të mos vendosen subvencione të tilla të reja, duke e pranuar se trajtimi i posaçëm dhe i diferencuar, i përshtatshëm dhe efektiv, për vendet në zhvillim dhe vendet më pak të zhvilluara, duhet të jenë pjesë integrale e negociatave për subvencione të peshkimit të Organizatës Botërore të Tregtisë [b]</p>	<p>14.6.1 Progresi nga vendet në shkallën e zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare që synojnë të luftojnë peshkimin e paligjshëm, të pa raportuar dhe të parregulluar</p>
<p>15.1 Deri në vitin 2020, të sigurohet ruajtja, restaurimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve tokësore dhe të ujërave të ëmbla të brendshme dhe shërbimet e tyre, në veçanti pyjet, ligatinat, malet dhe tokat e thata, në përputhje me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare</p>	<p>15.1.2 Përqindja e lokacioneve të rëndësishme për biodiversitetin tokësor dhe të ujërave të ëmbla që mbulohen nga zona të mbrojtura, sipas llojit të ekosistemit</p>
<p>15.4 Deri në vitin 2030, të sigurohet ruajtja e ekosistemeve malore, përfshirë biodiversitetin e tyre, në mënyrë që të rritet kapaciteti i tyre për të siguruar përfitime që janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm</p>	<p>15.4.2 Indeksi i Mbulesës të Gjelbër të Maleve</p>
<p>15.a Të mobilizohen dhe rriten ndjeshëm resurset financiare nga të gjitha burimet për ta ruajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme biodiversitetin dhe ekosistemet</p>	<p>15.a.1 Ndihma zyrtare për zhvillim dhe shpenzimet publike për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit dhe ekosistemeve</p>
<p>15.b Të mobilizohen resurse të ndjeshme nga të gjitha burimet dhe në të gjitha nivelet për të financuar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe për të siguruar stimuj adekuatë për vendet në zhvillim për ta avancuar një menaxhim të tillë, përfshirë konservimin dhe ripllëzimin</p>	<p>15.b.1 Ndihma zyrtare për zhvillim dhe shpenzimet publike për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit dhe ekosistemeve</p>
<p>17.1 Të forcohet mobilizimi i burimeve të brendshme, duke përfshirë përmes mbështetjes ndërkombëtare për vendet në zhvillim, për të përmirësuar kapacitetin e brendshëm për mbledhjen e tatimeve dhe të ardhurave të tjera</p>	<p>17.1.1 Të ardhurat totale të qeverisë si pjesë e BPV-së, sipas burimit</p>
<p>17.3 Të mobilizohen burime shtesë financiare për vendet në zhvillim nga burime të shumëfishta</p>	<p>17.3.1 Investimet e huaja direkte (IHD), ndihma zyrtare për zhvillim dhe bashkëpunimi Jug-Jug si përqindje e buxhetit të përgjithshëm vendor</p>

CAKU	TREGUESI
<p>17.9 Të përmirësohet mbështetja ndërkombëtare për zbatimin e ndërtimit efektiv dhe të targetuar të kapaciteteve në vendet në zhvillim për të mbështetur planet kombëtare për të zbatuar të gjithë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, përfshirë përmes bashkëpunimit Veri-Jug, Jug-Jug dhe trekëndor</p>	<p>17.9.1 Vlera në dollar e asistencës financiare dhe teknike (përfshirë përmes bashkëpunimit Veri-Jug, Jug Jug dhe trekëndor) të përkushtuar për vendet në zhvillim</p>
<p>17.10 Të promovohet një sistem shumëpalësh tregtar universal, i bazuar në rregulla, i hapur, jodiskriminues dhe i barabarta nën Organizatën Botërore të Tregtisë, përfshirë përmes përfundimit të negociatave në kuadër të Agjendës së saj Zhvillimore të Dohas</p>	<p>17.10.1 Tarifa mesatare e peshuar për mbarë botën</p>
<p>17.15 Të respektohet hapësira dhe udhëheqja e politikave të secilit vend për të krijuar dhe zbatuar politika për çrrënjosjen e varfërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm</p>	<p>17.15.1 Të zgjerohet përdorimi i kornizave të rezultateve në pronësi të vendit dhe mjeteve të planifikimit nga siguruesit e bashkëpunimit zhvillimor</p>



UNITED NATIONS
KOSOVO TEAM

